



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:215414

Datë: 28.02.2024

Numri i dokumentit: 05396961

PS.nr.2/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI SPECIAL, kryetari i trupit gjykues Mentor Bajraktari, me zyrtaren ligjore Mirjetë Demiri, në çështjen penale ndaj të akuzuarve; K K nga Fushë Kosova, E Rr nga Vushtrria, B Z nga fshati Vllasali, Komuna e Novobërdës, H H nga Fushë Kosova, E A nga Prishtina dhe G T nga Tirana, Republika e Shqipërisë, për shkak të veprës penale: Kontrabandimi me migrantë në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 164 par. 2 lidhur me nenet 31 dhe 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës¹, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës², me numër PPS.nr.80/2023, të datës 15.01.2024, pas mbajtjes së seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë **me datën 31.01.2024**, në prezencën e Prokurores së shtetit nga PSRK Florije Salihu – Shamolli, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre avokatëve: Berat Tmava, Sabri Ademi, Adelina Hoxha, Fllanza Kadiu, Driton Muharremi, Shkelzen Sopjani, Sylë Hoxha, Burim Halili dhe Ilaz Rudaku, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 28.02.2024 përpilojë këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. K K, nga i ati .. dhe e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datë ..., në ..., Komuna e Medvegjes, tani me vendbanim në Fushë Kosovë, në rrugën “...” numër .., i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK-së), nr.06/L-074, i datës 14.01.2019, i cili ka hyrë në fuqi më 19.04.2019.

² Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, (Në tekstin e mëtejshëm PSRK-së).

2. E RR, nga i ati ... dhe e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datë ..., në Mitrovicë, tani me vendbanim në Komunën e Vushtrrisë, në lagjen “...” ne rrugën “...” numër ..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

3. B Z, nga i ati ... dhe e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datë ..., në Novobërdë, me vendbanim në fshatin ..., Komuna Novobërdë, i pa martuar, ka të kryer dy (2) vite te shkollës se mesme, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar - shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ...

4. H H, nga i ati ... dhe e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datën ..., ne Gjonaj, Komuna Prizren, me vendbanim ne rrugën “...” numër ..., Fushe Kosove, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, punon si furrtar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar - shtetas i Republikës së Kosovë, me numër personal; ...

5. E A, nga i ati ... dhe e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datën ..., ne Beograd, tani me vendbanim ne rrugën “...” nr.3, ..., lagjja ..., Komuna Prishtine, i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, ka të kryer Fakultetin Ekonomik, ekonomist i diplomuar, ka punuar si menaxher i shitjes ne kompaninë “...”, material ndërtimor ne Prishtinë, i gjendjes së mesme ekonomike shqiptar - shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal; ...

6. G T, nga i ati ..., dhe e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me ..., në Tropoje, Republika e Shqipërisë, me vendbanim në rrugën “...”, Lagjja 6, Tiranë - tek kombinati i tekstilit, i martuar, baba i tre (3) fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa pune, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar - shtetas i Republikës së Shqipërisë, me numër personal ...

JANË FAJTOR

Sepse të akuzuarit K K, E A, G T, H H, E Rr dhe B Z, në bashkëveprim gjatë vitit 2023, në Republikën e Kosovës por edhe nga vendet tjera jashtë Republikës së Kosovës, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për tjetrin kanë falsifikuar dokumente të ndryshme me qëllim që qytetarëve të ndryshëm tu mundësojnë kontrabandimin në vendet e ndryshme evropiane, ashtu që;

I. I akuzuari **K K**, duke bashkëvepruar me të akuzuarin **H H**, fillimisht ka siguruar një banesë në Fushë Kosovë, me qëllim që t'i vendos aparaturat për falsifikim të dokumenteve, pastaj i akuzuari **K K** ka siguruar shtetas të nacionaliteteve të ndryshëm kryesisht shtetas të huaj si: **D R**, **V V**, **A D**, **A D**, **V S**, **M D**, **E I**, **S N**, **Xh R**, **S F**, **M K**, **D D**, etj, që kanë dashur të migrojnë nëpër vende të ndryshme të Evropës si Rumani, Itali, Francë, Mbretëri se Bashkuar, Zvicër, Kroaci, Slloveni, Spanjë etj, përmes aplikacioneve Viber, WhatsApp, ju ka kërkuar të dhënat personale, apo edhe ndonjë kopje të dokumenteve identifikuese, pastaj i akuzuari **K K** me ata qytetar ka arritur marrëveshje për mënyrën e pranimit dhe dërgimit të dokumenteve si dhe për çmimin, ndërsa pasi këto të dhëna i ka falsifikim me ndihmën e një personi tjetër (për të cilin tani për tani nuk kemi të dhëna të plota), të njëjtat dokumente i akuzuari **K K**, herë ua ka dorëzuar personave që i kanë kërkuar vet, të cilët edhe kanë bërë pagesën herë tek i akuzuari **K K** në shumën prej 900 Euro, përmes institucioneve mikrofinanciare si Rio, Western Union si dhe Money Gram, herë ua ka dorëzuar përmes të akuzuarit e tjerë;

II. I akuzuari **E A** në bashkëveprim me të akuzuarin **K K**, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për tjetrin, duke vepruar sipas sugjerimeve të të akuzuarit **K K**, dokumente të ndryshme të cilat i kishte falsifikuar i akuzuari **K K** (siç është përshkruar nën pikën I.) i ka dërguar përmes postës DHL, tek personat ndryshëm si tek **A D**, **V S**, **M D**, **E I**, **S N**, **Xh R**, **S F**, **M K**, **D D**, etj, në vendet e ndryshëm të Evropës si Rumani, Itali, Francë, Mbretëri se Bashkuar, Zvicër, Kroaci, Slloveni, Spanjë, etj, për dërgimin e dokumenteve të falsifikuara, nga personat e ndryshëm përmes institucioneve mikrofinanciare si Rio, Wester Union si dhe Money Gram, ka pranuar mjete materiale në shuma të ndryshme duke filluar prej 300 – 900 Euro, varësisht nga shërbimi që i kryer dhe nga marrëveshja me të akuzuarin **K K**;

III. I akuzuari **H H** në bashkëveprim me të akuzuarin **K K**, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për tjetrin, ka marrë me qira një banesë në Fushë Kosovë, ku i ka mundësuar të akuzuarit **K K** t'i vendos aparaturat për falsifikim të dokumenteve, pastaj duke vepruar sipas sugjerimeve të të akuzuarit **K K**, dokumente të ndryshme të cilat i kishte falsifikuar i akuzuari **K K** (siç është përshkruar nën pikën I.) përmes postës DHL i ka dërguar tek personat e ndryshëm si tek **A H**, **A K**, **N P**, **E B**, **D K**, **E B** etj, në vendet të ndryshme të Evropës si Mbretëri se Bashkuar, Spanjë dhe Portugali, për dërgimin e dokumenteve të falsifikuara, nga personat e ndryshëm përmes institucioneve mikrofinanciare si Rio, Wester Union si dhe Money Gram, ka

pranuar mjete materiale në shuma të ndryshme duke filluar prej 300 – 900 Euro, varësisht nga shërbimi që i kryer dhe nga marrëveshje me të akuzuarin K K;

IV. I akuzuari **G T**, duke bashkëvepruar me të akuzuarin K K, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për tjetrin, ka siguruar personat të ndryshëm që ishin të interesuar të pajisen me dokumentet të ndryshe si A N që ishte i interesuar për falsifikimin e pasaportës, letërnjoftimi dhe patentë shoferë të Greqisë dhe L B që ishte i interesuar për falsifikimin e pasaportës, letërnjoftimi dhe patentë shoferë të Italisë, ka marre të dhënat e tyre, një fotot pastaj, për një dokument të tillë ka pranuar nga 2000 euro, pastaj përmes të akuzuarit K K i ka falsifikuar, këto dokumentet të cilat janë sekuestruar tek i akuzuari K K dhe pas ekzaminimit nga AKF ka rezultuar të jenë të tërësi të falsifikuara;

V. I akuzuari **E RR**, në bashkëveprim me të akuzuarin K K, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për tjetrin, duke vepruar sipas sugjerimeve të të akuzuarit K K, dokumente të ndryshme të cilat i kishte falsifikuar i akuzuari K K (*siç është përshkruar nën pikën I.*) i ka dërguar përmes postës DHL, tek personat ndryshëm si tek, një herë tek personi K A në Mbretëri se Bashkuar dhe një here tjetër tek A S, në Portugali, pastaj për dërgimin e dokumenteve të falsifikuara, nga personat e ndryshëm përmes institucioneve mikrofinanciare si Rio, Wester Union si dhe Money Gram, disa here ka pranuar mjete materiale në shuma të ndryshme duke filluar prej 300 – 900 Euro, varësisht nga shërbimi që i kryer dhe nga marrëveshja me të akuzuarin K K;

VI. I akuzuari **B Z**, në bashkëveprim me të akuzuarin K K, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për tjetrin, duke vepruar sipas sugjerimeve të të akuzuarit K K, disa here ka pranuar mjete materiale përmes institucioneve mikrofinanciare si Rio, Wester Union si dhe Money Gram, në shuma të ndryshme deri në 800 Euro, për dërgimin e dokumenteve të falsifikuar në vende evropiane dhe varësisht nga shërbimi që i kryer dhe nga marrëveshja me të akuzuarin K K edhe ka përfituar mjete materiale.

Me këto veprime kanë kryer veprën penale: Kontrabandimi me migrantë në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 164 par.2 lidhur me nenet 31 dhe 77 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 2, 4, 6, 7, 17 par.1, 38, 42, 43, 69, 70, 79, 92 dhe 164 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 366 dhe 450 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës³, si dhe nenit 36 par.3 nënpar.3.3 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimin, të akuzuarit i:

G J Y K O N

1. Të akuzuarin K K;

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej dy (2) vite e gjashtë (6) muaj, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 10.10.2023 deri më 31.01.2024.

ME DËNIM ME GJOBË, në shumë prej dhjetëmijë (10.000,00) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej tre (3) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

2. Të akuzuarin E RR;

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 10.10.2023 deri më 31.01.2024.

ME DËNIM ME GJOBË, në shumë prej tremijë (3.000,00) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej dy (2) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

3. Të akuzuarin B Z;

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 12.10.2023 deri më 31.01.2024.

³ Kodi i Procedurës Penal (Në tekstin e mëtejme KPP-së), nr.08/L-032, i datës 14.07.2022, i cili ka hyrë në fuqi më 18.04.2023.

ME DËNIM ME GJOBË, në shumë prej pesëqind (500,00) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej një (1) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

4. Të akuzuarin H H;

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 10.10.2023 deri më 31.01.2024.

ME DËNIM ME GJOBË, në shumë prej dymijë (2000,00) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej një (1) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

5. Të akuzuarin E A;

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 10.10.2023 deri më 31.01.2024.

ME DËNIM ME GJOBË, në shumë prej tre (3.000,00) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej dy (2) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

6. Të akuzuarin G T;

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) viti, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 10.10.2023 deri më 31.01.2024.

ME DËNIM ME GJOBË, në shumë prej gjashtëmijë (6.000,00) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej dy (2) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse të akuzuarit e lartpërmendur, nuk dëshirojnë ose nuk mundën ti paguajnë dënimet me gjobë, atëherë të akuzuarve dënimet me gjobë i'u zëvendësohen secilit veç e veç me dënim me burgim, duke e llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim nga njëzet (20) Euro, ashtu që:

1. Të akuzuarit K K, i zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej pesëqind (500) ditëve.

2. Të akuzuarit **E RR**, i zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqindpesëdhjetë (150) ditëve.
3. Të akuzuarit **B Z**, i zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëzetepesë (25) ditëve.
4. Të akuzuarit **H H**, i zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqind (100) ditëve.
5. Të akuzuarit **E A**, i zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqindpesëdhjetë (150) ditëve.
6. Të akuzuarit **G T**, i zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej treqind (300) ditëve.

I. KONFISKOHEN ndaj të akuzuarve të poshtë shënuar, **mjetet dhe pasuritë që janë përdorur me kryerjen e veprës penale, pra objekt i veprës penale, ashtu që:**

I/I. Ndaj të akuzuarit K K, KONFISKOHEN:

1. Një (1) bllok më ngjyrë të zezë me shënime;
2. Një (1) faqe e vizës në emër të J S, me numër serik: ...;
3. Një (1) pasaportë e Kosovës në emër të Burim Krasniqi me numër të pasaportës: K00678824;
4. Një (1) kartë identifikimi të shtetit të Holandës në emër të D Z, me numër ..;
5. Tre (3) OV-CHIPKAART;
6. Një (1) kartelë në emër të L K, me numër serik; ...;
7. Një (1) pako letër e bardhë – firma “...”;
8. Një (1) letra të bardha kartoni, 2 letër karton, 3 zarfe të bardha,
9. Një (1) pako material për plastifikim;
10. Dymbëdhjetë (12) materiale për mbështjellje me ngjyra të ndryshme;
11. Një (1) skaner për monedha model; ...;
12. Një (1) USB dhe dy kartela;
13. Pesëmbëdhjetë (15) CHIPA për dokumente;
14. Një (1) prerës për dokumente;
15. Një (1) role pa ngjyra me CHIPA;
16. Një (1) printer i bardhë Hlme, me numër serik: ...;
17. Një (1) printer i zi/hiri, HP me numër serik: ...;

18. Dy (2) pako letra për plastifikim formati A3-A4;
19. Tri (3) foli për kartela;
20. Dy (2) palë pranga me katër çelësa të prangave;
21. Një (1) shufër metalike me fotrollë;
22. Dy (2) thika me fotrolla tehu rreth 12.5 cm;
23. Një (1) brisk fluturake 11 cm;
24. Shtatëmbëdhjetë pasaporta (17), (1 pasaportë e Çekisë, 1 pasaportë e Austrisë dhe 15 pasaporta Italiane);
25. Një (1) aparat për ngjitje të folisë me dokumente (villager VLN200) me numër serik: 21202200835;
26. Një (1) lexues i kartelave modeli: ZM-110AK, me numër serik: ...;
27. Një (1) pasaportë e shteti të Greqisë, me numër serik: ... (e gjetur në çantë dore);
28. Një (1) patentë shofer i shtetit të Greqisë, me numër serik: ...;
29. Një (1) letërnjoftim i shtetit të Greqisë, me numër serik: ...;
30. Një (1) pasaportë e shtetit të Italisë, me numër serik: ...;
31. Një (1) patentë shofer i shtetit të Italisë, me numër serik: ...;
32. Një (1) letërnjoftim i shtetit të Italisë me numër serik: ...;
33. Parat në shumë prej njëmijegjashtëqind (1.600) Euro, (pra gjashtëmbëdhjetë (16) kartëmonedha nga 100 Euro, 16x100 Euro);
34. Parat në shumë prej tridhjetë (30) £ Funta, (pra dy (2) kartëmonedha £ Funte, të shtetit të Anglisë, 1x10, 1x20 £Funte);
35. Parat në shumë prej dymijeshtatëqind (2700) Lekë, (pra tre (3) kartëmonedha Lekë, të shtetit të Shqipërisë, 1x2000, 1x500, 1x200 Lekë);
36. Parat në shumë prej shtatëqindeshtatëdhjetë e pesë 755 Lira Turke, pra shtatë (7) kartëmonedha Lira të shtetit të Turqisë (2x200, 1x100, 1x50, 2x20, 1x5, Lira turke);
37. Një (1) telefon “SAMSUNG” A135, me numër të IMEI-1:..., IMEI-2: ...;
38. Një (1) telefon “SAMSUNG” – GALAXY – Z, me numër të IMEI-1: ..., IMEI-2: ...;
39. Tre (3) SIM karte të ndryshme;
40. Një (1) pliko zarf i bardhë;
41. Faturë dy fletë, “DHL Exper”, në emër të personit Mario Dollani ...;
42. Faturë dy fletë, “DHL Exper”, në emër të personit Stari Frashëri ...;
43. Faturë “Rikon” SH.P.K ...;
44. Faturë “Western Union”, në emër të personit K K...;
45. Autorizim i veturës RP. Nr. 620/2022;

46. Një (1) Veturë “Peugeot C”, me targa të regjistrimit 01-489-PE, me numër serik: ...
– së bashku e Librezën e Qarkullimit me nr.CRA ...;
47. Një (1) çelës i veturës “Peugeot C”, me targa 01- 489- PE.

I/2. Ndaj të akuzuarit E Rr KONFISKOHEN:

1. Një (1) Pasaportë e Republikës së Kosovës, me numër:..., e dëmtuar, me emër V B;
2. Një (1) Fletore me kopertin të kuqe me shënime;
3. Një (1) telefon “IPHONE” 7, ngjyrë e zezë, me SIM kartelë me numër: ..., me numër të IMEI: ...;
4. Një (1) pajisje me dritë UV (ultravjollcë) Model AD-2138;
5. Pesë (5) kartela blanko, ngjyrë të bardhë.

I/3. Ndaj të akuzuarit H H KONFISKOHET:

1. Një (1) telefon “IPHONE”, me numër serik: ...;

I/4. Ndaj të akuzuari E A KONFISKOHET:

1. Një (1) telefon “SAMSUNG” GALAXY A03, ngjyrë e zezë, me SIM kartelë me numër: ..., me IMEI-1: ... IMEI-2: ...

I/5. Ndaj të akuzuarit G T, KONFISKOHET:

1. Një (1) telefon “IPHONE”, ngjyrë e zezë, i sekuestruar sipas urdhëresës së gjyqtarit të procedurës paraprake të kësaj gjykate me numër PP.nr.1359/23.

II. OBLIGOHET Agjencia për Sekuestrimin e Pasurisë së Konfiskuar në Prishtinë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi t`i marr nën administrim dhe menaxhim sendet e konfiskuara përkatësisht paratë dhe pasuritë si në pikën I – I/1, I/2, I/3, I/4, I/5, ashtu që Agjencia ka të drejtë që të administrojë me të njëjtat dhe me sendet e lartcekura t`i shesë dhe paratë nga shitja t`i administroi në përputhje me Ligjin mbi Agjencinë.

III. KTHEHEN ndaj të akuzuarve të poshtë shënuar, mjetet përkatësisht pasuritë të cilat janë sekuestruar sipas Urdhrit Ndalues Përfundimtar të kësaj Gjykate me numër: PPPS.nr.52/23, të datës 17.11.2023, për shkak se PSRK ka kërkuar kthimin e tyre dhe atë:

III/1. Të akuzuarit K K, i KTHEHET:

1. Një (1) telefoni i tipit “SAMSUNG” që mban kartelën me numër ..., pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III/2. Të akuzuarit Berat Zeneli, i KTHEHET:

1. Një (1) telefon “SAMSUNG”, ngjyrë e zezë, me SIM kartelë me numër:... me numër serik: ...;

III/3. Të akuzuarit G.. T, i KTHEHEN:

1. Letra të vogla të dorë shkruara (5 letra);
2. Fotografi të personit të pa identifikuar (2 fotografi) dhe dy letra me të dhëna;
3. Parat në shumë prej dyqindpesëdhjetë (250) Euro, (pra kartëmonedhat 5x50 Euro);
4. Parat në shumë prej dhjetë (10) Euro, (pra 1x10 Euro);
5. Parat në shumë prej tridhjetëmijë (30.000) Lekë Shqiptare, (pra kartëmonedhat 6x5000 lekë Shqiptare)
6. Parat në shumë prej gjashtëmbëdhjetëmijë (16.000) Lekë Shqiptare, (pra kartëmonedhat 16x1000 Lekë Shqiptare).
7. Vetura Opel Zafira, me numër: ..., me targa të regjistrimit ..., pronë e të akuzuarit G T;
8. Leja e qarkullimit me numër: , pronë e të akuzuarit G T;
9. Një (1) çelës i veturës së lartpërmendur, pronë e të akuzuarit G T.

IV. OBLIGOHET Agjencia për Sekuestrimin e Pasurisë së Konfiskuar në Prishtinë, që Po ashtu, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi t`iu dorëzojë të akuzuarve mjetet dhe pasuritë e lartpërmendura si në pikën **III-III/1, III/2, III/3, përkatësisht të bëjë** kthimin e mjeteve dhe pasurive, meqenëse PSRK ka kërkuar kthimin e tyre – pra nuk ka bazë për konfiskimin e tyre.

V. DETYROHEN të gjithë akuzuarit e lartpërmendur që t'i paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej njëqind (100) Euro, si dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç shumën prej njëqind (100) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, pranë kësaj Gjykate me datën 15.01.2024, ka ngritur aktakuzën, me numër PPS.nr.80/2023, të datës 15.01.2024, ndaj të akuzuarve K K, E RR, B Z, H H, E A dhe G T, për shkak të veprës penale: Kontrabandimi me migrantë në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 164 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së.

PSRK së bashku me aktakuzë, Gjykatës i ka dorëzuar edhe marrëveshjet për pranimin e fajësisë me numër PPS.nr.80/2023, të datës 09.01.2024, të lidhura në mes të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, përkatësisht Prokurores së shtetit nga PSRK Habibe Salihu, Kryeprokurorit të PSRK-së Blerim Isufaj në njërën anë, si dhe të akuzuarit K K dhe mbrojtësve të tij avokatëve Berat Tmava dhe Sabri Ademi në anën tjetër, të akuzuarit E Rr dhe mbrojtëses së tij avokates Adelina Hoxha, të akuzuarit E A dhe mbrojtësit të tij avokatit Driton Muharremi, të akuzuarit B Z dhe mbrojtëses së tij avokates Fllanza Kadiu, të akuzuarit H Hdhe mbrojtësve të tij avokatëve Sylë Hoxha dhe Shkelzen Sopjani, si dhe të akuzuarit G T dhe mbrojtësve të tij avokatëve Ilaz Rudaku dhe Burim Halili, marrëveshje kjo e lidhur me datë 24.01.2024.

Sipas marrëveshjeve PSRK, gjykatës i është rekomanduar që ndaj të akuzuarve të shqiptohen dënimet si në dispozitivë të këtij aktgjykimi, për shkak të veprës penale: Kontrabandimi me migrantë në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 164 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së si dhe të konfiskohen dhe të kthen mjetet dhe pasurisë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me datën 31.01.2024, në të cilën seancë janë shqyrtuar marrëveshjet për pranimin e fajësisë, ku janë dëgjuar të akuzuarit K K, E RR, B Z, H H, E A dhe G T, Prokurorja e shtetit nga PSRK Florije Salihu Shamolli, si dhe mbrojtësit i të akuzuarve av.Berat Tmava dhe Sabri Ademi,

Adelina Hoxha, Fillanza Kadiu, Driton Muharremi, Shkelzen Sopjani dhe Sylë Hoxha dhe Burim Halili dhe Ilaz Rudaku.

Prokurorja e shtetit nga PSRK Florije Salihu – Shamolli, gjatë seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se: në aktakuzë është përvjedhur një gabim teknik për shkak se në akuzë tek kualifikimi juridik është shënuar neni 164 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, e në fakt kualifikimi juridik në akuzë duhet të jetë se të njëjtit kanë kryer veprën penale nga neni 164 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, ashtu edhe siç janë lidhur marrëveshjet për pranimin e fajësisë, për shkak se gjatë përpilimit të akuzës është përvjedhur një gabim teknik.

Të akuzuarit K K, E RR, B Z, H H, E A dhe G T, gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë kanë deklaruar se: marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë e ka nënshkruar personalisht pas konsultimeve mjaftueshme me mbrojtësit e tyre, duke shtuar se e kuptojnë faktin se me pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë heqin dorë nga e drejta në gjykim të rregullt si dhe të gjitha të drejtat që kanë të bëjnë me një gjykim të rregullt, në vazhdim ka theksuar se nuk kanë qenë të kërcënuar dhe as të detyruar që të pranojnë fajësinë dhe nuk ju ka bërë dikush ndonjë premtim që ta shtyjë ta pranojnë fajësinë.

Të akuzuarit K K, E RR, B Z, H H, E A dhe G T, kanë deklaruar se e kuptojnë aktakuzën përkatësisht veprën penale, e cila i vihet në barrë me aktakuzë dhe secili veç e veç janë deklaruar se e pranojnë fajësinë për veprën penale: Kontrabandimi me migrantë në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 164 par. 2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së.

Prokurorja e shtetit Florije Saliu – Shamolli, gjatë seancës ka theksuar se Prokuroria Speciale konform dispozitave ligjore ka negociuar dhe ka arritur të bëjë marrëveshje për pranimin e fajësisë me të akuzuarit dhe bashku me mbrojtësit e tyre, andaj meqë tani të akuzuarit ashtu siç janë deklaruar në prokurori, edhe sot bënë pranimin e këtyre marrëveshjeve, propozoj gjykatës që këto marrëveshje të pranohen pasi që të njëjtat janë konform dispozitave ligjore të nënshkruara nga zyra e kryeprokurorit të shtetit dhe siç thanë të akuzuarit nuk kanë pasur shtytje, presion apo kanosje dhe me vetëdije dhe vullnet e kanë bërë këtë dhe me prezencën e mbrojtësve të tyre dhe i propozoj gjykatës që të aprovoje këtë marrëveshje meqë nuk ka asnjë pengesë ligjore.

Mbrojtësi i të akuzuarit K K, av.Berat Tmava, gjatë seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë kanë deklaruar se; e mbështes deklarimin e të mbrojturit tonë dhe po ashtu edhe propozimin e prokurorisë ashtu që ka propozuar që të aprovohet marrëveshja e arritur në prokurori për pranimin e fajësisë sepse pas konsultimit paraprak me të, në cilësinë e avokateve të bashku me kolegun av.Sabri Ademi kemi ardhur në përfundim se i mbrojturi jonë i ka kuptuar të gjitha benifitet dhe pasojat lidhur me pranimin e fajësisë pra këtë veprim procedural dhe lidhur me lartësinë e dënimit kanë kërkuar nga gjykata që të ketë parasysh meqë i njëjti nuk ka rënë asnjëherë ndesh me ligjin.

I akuzuari K K, gjatë seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se: pajtohem në tërësi me theksimet e mbrojtësit dhe nuk kam çka të shtojë tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit E Rr av.Adelina Hoxha gjatë seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se gjykatës i propozojë që këtë marrëveshje të lidhur me prokurorinë të aprovohet në tërësi, meqë kjo marrëveshje është lidhur sipas dispozitave ligjore të KPP-së respektivisht nenit 230, dhe nuk ka asnjë arsye objektive faktike dhe ligjore që e njëjta të refuzohet.

I akuzuari E RR, gjatë seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se pajtohem me deklaratimet e mbrojtëses së tij dhe nuk kam çka të shtojë tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit B Z av.Fllanza Kadiu. gjatë seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se e mbështet në tërësi deklarimin e të mbrojturit të saj, kur ka pranuar fajësinë dhe po ashtu përkrahi propozimin e prokurorisë dhe i gjykatës i ka propozuar që të pranohet marrëveshja për pranimin e fajësisë, duke shtuar se i mbrojturi i saj është këshilluar mjaftueshëm me të si mbrojtëse e njëjta e ka njoftuar për benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë të akuzuarin mjaftueshëm.

I akuzuari B Z, gjatë seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se pajtohet me theksimet e mbrojtëses së tij dhe nuk ka pasur të shtojë diçka tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit H H, av.Shkelzen Sopjani, gjatë seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se bashku me kolegun tim av.Sylë Hoxhaj, e mbështesim në tërësi deklarimin e të mbrojturit të tyre për pranimin e fajësisë dhe se me të

mbrojturin e tyre janë konsultuar mjaftueshëm, i njëjti i ka të qarta edhe benefitet edhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe po ashtu vlerësojnë se marrëveshja është në përputhje të plotë me nenin 230 të KPPRK- se dhe i kanë rekomanduar gjykatës që të njëjtën ta aprovoje.

I akuzuari H H, gjatë seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se; pajtohem ne tërësi me theksimet e mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit E A, av.Arber Krasniqi, gjatë seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se; mbesin pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë e lidhur mes prokurorisë dhe E A dhe i kanë propozuar gjykatës që ta aprovoje këtë marrëveshje pasi që e njëjta është lidhur konform dispozitave ligjore.

I akuzuari E A, gjatë seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se pajtohet me theksimet e mbrojtësit të tij dhe nuk ka çka të shtojë tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit G T, av. Burim Halili gjatë seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se; i propozojnë gjykatës që të aprovoje marrëveshjen e arritur me datën 24.01.2024, lidhur me klientin e tyre G T, pasi që e njëjta marrëveshje ishte lidhur pas konsultimit të mjaftueshëm me klientin e tyre së bashku me kolegun e tij av.Ilaz Rudaku dhe pasi i njëjti ishte njoftuar për benefitet e marrëveshjes ne këtë procedurë dhe po ashtu e njëjta është edhe në përputhje me KPP-ne dhe i kanë propozuar gjykatës të aprovoje. Mbrojtësi shtuar se ditën e lidhjes se kësaj marrëveshje me prokuroren janë pajtuar që gjërat që janë konfiskuar me arrestimin e G me përjashtim të telefonit të lirohen, gjërat që duhet të lirohen janë; leja e qarkullimit, vetura dhe kane qene 260 €uro dhe 46.000 mije Lekë Shqiptare.

I akuzuari G T, gjatë seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka deklaruar se pajtohet ne tërësi me theksimet e mbrojtësit të tij dhe nuk ka shtuar diçka tjetër.

Prokurorja e shtetit Florije Shamolli Salihu, gjatë seancës dëgjimore lidhur me kërkesën për sekuestrimin dhe kthimin e sendeve nga mbrojtësi i të akuzuarit G T, av.Burim Halili, ka deklaruar se nga i akuzuarit G T duhet të konfiskohet vetëm telefoni që është bërë me marrëveshja ndërsa pjesa tjetër ë gjësendeve që janë sekuestruar me urdhër me të gjyqtarit të procedurës paraprake të kësaj gjykate duhet të kthehen pasi që kështu jemi pajtuar në marrëveshjen për pranimin e fajësisë mirëpo nuk është precizuar në marrëveshje.

Prokurorja e shtetit Florije Salihu Shamolli, gjatë seancës në lidhje me dënimet ka deklaruar se ashtu siç e thamë gjatë rrjedhës se kësaj seance me te akuzuarin e parë K K, është arritur marrëveshja ku për veprën penale Kontrabandimi me migrantë nga neni 164 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, është paraparë që ti shqiptohet dënim me 2 vite e 6 muaj Burg dhe Dënim me Gjobë në shumë prej 10.000 Euro, ndërsa siç e thash edhe me larte sipas urdhëresës se GJPP-se janë sekuestruar sendet të cilat duhet të konfiskohen mirëpo duhet ti kthehet telefoni Samsung se bashku me kartelën me numër Për të akuzuarin e dytë E RR, për veprën penale te ngarkuar është paraparë ti shqiptohet dënim me një (1) vit burgim dhe Dënim me Gjobë prej 3000 Euro dhe ti konfiskohet telefoni që është përdorur ne kryerjen e veprës penale i cili është sekuestruar sipas vendimit te GJPP-së gjatë kontrollit të shtëpisë së tij. Për të akuzuarin B Z për veprën penale që është ngarkuar dënimi prej një (1) vit burgim dhe Dënim me Gjobë 500 Euro dhe ti kthehet telefoni që i është sekuestruar. Për të akuzuarin E A, është arritur marrëveshja që ti shqiptohet Dënim me burg prej një (1) vit dhe Dënim me Gjobë 3000 Euro dhe ti konfiskohet telefoni. Për të akuzuarin H H, Dënimi prej një (1) vit burgim dhe Dënim me Gjobë prej 2000 Euro dhe ti konfiskohet telefoni që është përdorur ne kryerjen e veprës penale. Për të akuzuarin G T, është arrit marrëveshja që ti shqiptohet dënim me burgim prej një (1) vit dhe Dënimi me Gjobë në shumën prej 6000 Euro, ndërsa për gjësendet tjera lidhur me konfiskimin dhe kthimin u deklarova me herët. Këto dënime të rekomanduara me marrëveshjet për pranimin e fajësisë janë parapare Konform dispozitave ligjore te Kodit Penale të Republikës së Kosovës dhe nuk besoj që ka pasur ndonjë shkelje prandaj edhe propozoj që këto dënime të rekomanduara ti shqiptohen të akuzuarve sipas marrëveshjeve për pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit K K, av.Berat Tmava, gjatë seancës në lidhje me dënimin ka deklaruar se gjatë lidhjes se marrëveshjes për pranimin e fajësisë jemi pajtuar me dënimin e rekomanduar për klientin tonë K K për veprën penale që ngarkohen sipas akuzës, Kontrabandimi me migrant nga neni 164 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, dhe për këtë vepër te shqiptohet dënimi prej 2 vite e 6 muaj dhe dënimi me Gjobe ne shume prej 10 mije euro. Mirëpo jemi konsultuar edhe me prokuroren e çështjes që dënimin me gjobë të ja mundësoje klientit tim që të paguhet se paku me 6 këste për shkak të gjendjes se tij ekonomike dhe po ashtu prokurorja ka deklaruar se te njëjtën gjë nuk do ta kundërshtojë dhe jemi të pajtimit që kjo shume te paguhet me këste nga ana e të akuzuarit kjo nuk është cek ne marrëveshje mirëpo ka qene vetëm një bisede me prokuroren e çështjes Habibe Salihu dhe për shkak te rrethanave nuk është prezent mirëpo gjate diskutimit ka thënë se nuk do të kundërshtojë këtë nëse kërkohet nga ana e juaj.

I akuzuari K K, gjatë seancës në lidhje me dënimin ka deklaruar se pajtohem me theksimet e mbrojtësit dhe dënimet e propozuar sipas marrëveshjes, nuk kam çka të shtojë tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit E RR, av. Adelina Hoxha gjatë seancës në lidhje me dënimin ka deklaruar se konsideroj se marrëveshja është e bazuar me ligj sipas nenit 230 të KPP-së dhe dënimi i propozuar nga prokuroria është i pranuar nga mbrojtja dhe nuk ka arsye që e njëjta të refuzohet andaj propozojmë që të shqiptohet dënimi sipas marrëveshjes.

I akuzuari E RR, gjatë seancës në lidhje me dënimin ka deklaruar se pajtohem me theksimet e mbrojtësit dhe dënimet e propozuar sipas marrëveshjes, nuk kam çka të shtojë tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit B Z, av. Fllanza Kadiu, gjatë seancës në lidhje me dënimin ka deklaruar se propozoj të aprovohet dënimi i rekomanduar nga prokuroria për të mbrojturin tim B Z pra dënimi me burg prej një (1) vit dhe dënimi me gjobe 500 Euro, pasi që kjo është përfundimi lidhur me marrëveshjes të cilën e kemi për pranim të fajësisë. Sa i përket dënimit me gjobë gjatë marrëveshjes ne kemi propozuar prokurores që për shkak të gjendjes skajshmërisht të varfër të mbrojturit tim ti mundësohet pagesa me këste me c'rast prokurorja e rastit na ka thënë se do të pajtohet me këtë propozim tonin pasi që pagimi me këste nuk është kompetence e Prokurorisë. Ngelem me shpresë se do të pranohet kjo marrëveshje dhe duke marrë parasysh dënimi i shqiptuar jemi të bindur se kanë pushuar edhe shkaqet për vazhdimin e masës së sigurisë të mbrojturit për të mbrojturin e tij, pra paraburgimit.

I akuzuari B Z, gjatë seancës në lidhje me dënimin ka deklaruar se ka deklaruar se pajtohem me theksimet e mbrojtësit dhe dënimet e propozuar sipas marrëveshjes, nuk kam çka të shtojë tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit H H, av. Shkelzen Sopjani, gjatë seancës për caktimin e dënimit ka deklaruar se pajtohem me propozimin siç është bërë në marrëveshje sa i përket dënimit, mirëpo marr parasysh gjendjen e rëndë ekonomike të mbrojturit dhe faktin se prokuroria ja ka lënë në diskrecion gjykatës mënyrën e pagesës së gjobës, kërkojmë nga gjykata që pagesa e gjobës të caktohet me këste dhe atë mundësisht prej 10 kësteve duke mos vështirësuar mbijetesën e të mbrojturit tonë. Njëkohësisht marrë parasysh rrethanat dhe faktin e pranimin të fajësisë dhe aprovimin e marrëveshjes vlerësojmë se kanë pushuar të gjitha arsyet e parapara me kodin e procedurës penale për masën e sigurisë se të pandehurit dhe si rrjedhojë i propozojmë gjykatës që e njëjta të ndërpritet sa me parë dhe atë duke filluar nga dita e sotme mundësisht.

I akuzuari H H, gjatë seancës për caktimin e dënimit ka deklaruar se ka deklaruar se pajtohem me theksimet e mbrojtësit dhe dënimet e propozuar sipas marrëveshjes, nuk kam çka të shtojë tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit E A, av.Driton Muharremi, gjatë seancës për caktimin e dënimit ka deklaruar se propozoj që ju të aprovoni këtë marrëveshje për pranimin e fajësisë e cila është në kuadër të dispozitave ligjore. Po ashtu propozojmë që pagesa e pjesës me gjobe ti mundësohet te mbrojturit tim te paguhet me këste pasi që tash i njëjti e ka humbur vendin e tij te punës dhe pagesa e tërësishme dhe menjëherë për te është e pa mundur, po ashtu propozoj që të njëjtit ti ndërprehet masa e paraburgimit duke pasur parasysh se tashmë kane pushuar te gjitha arsyet që është caktuar dhe vazhduar paraburgimi tashme mbi 3 muaj

I akuzuari E A, gjatë seancës për caktimin e dënimit ka deklaruar ka deklaruar se pajtohem me theksimet e mbrojtësit dhe dënimet e propozuar sipas marrëveshjes, nuk kam çka të shtojë tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit G T av.Burim Halili, gjatë seancës në lidhje me dënimin, ka deklaruar se propozojmë që të aprovohet marrëveshja lidhur me dënimin e caktuar dhe gjobën njëkohësisht i propozojmë gjykatës të ndërpritet paraburgimi pasi që tashme nuk qëndrojnë arsyet për vazhdimin e paraburgimit.

I akuzuari G T, gjatë seancës në lidhje me dënimin ka deklaruar ka deklaruar se pajtohem me theksimet e mbrojtësit dhe dënimet e propozuar sipas marrëveshjes, nuk kam çka të shtojë tjetër.

2. Vlerësimi i marrëveshjeve për pranimin e fajësisë

Në seancën publike për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të mbajtur me datën 31.01.2024, pas shqyrtimit të marrëveshjeve për pranimin e fajësisë të paraqitur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, me numër PS.nr.80/2023, të datës 15.01.2024, e cila ka të bëjë me të akuzuarit K K, E RR, B Z, H H, E A dhe G T, për shkak të veprës penale: Kontrabandimi me migrantë ne bashkëkryerje dhe ne vazhdimësi nga neni 164 par. 2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, si dhe deklarimit për pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarve në pajtim me dispozitat e nenit 230 par.17 të KPP-së, Gjykata ka gjetur se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pranimi i fajësisë është bërë në

mënyrë të vullnetshme pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tyre, të akuzuarit nuk ka qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza. Gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë faktin se të akuzuarit kanë kryer veprën penale me të cilën ngarkohen me aktakuzë dhe atë duke u bazuar në pranimin e fajësisë nga vet të akuzuarit dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe si dhe në provat tjera të cilat i përmban aktakuza të cilat prova janë të mjaftueshme për të vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ku gjithashtu gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 248 par.1 dhe 2 të KPP-së për pushimin e procedurës përkatësisht hedhjen e aktakuzës. Prandaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësve të të akuzuarve, ka marrë aktvendim me të cilin i ka pranuar marrëveshjet për pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë kanë mbështetje ligjore dhe bazuar në nenin 230 par.20 të KPP-së, të njëjtat marrëveshje i ka pranuar dhe i ka vendosur në shkresat e lëndës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë kryetari i trupit gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- Se të akuzuarit K K, E RR, B Z, H H, E A dhe G T, me dashje kanë kryer veprën penale: Kontrabandimi me migrantë në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 164 par.2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 164 paragrafi 2 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale: Kontrabandimi me migrantë e kryen: “*Kushdo që me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore, prodhon, furnizon, siguron ose posedon dokument të rrejtshëm të udhëtimit ose të identifikimit me qëllim të mundësimin të kontrabandimit me migrantë, dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë euro (500.000) dhe me burgim deri në pesë (5) vjet*”.

Ndërsa në nenin 31 të KPRK-së, është parashikuar bashkëkryerja si formë e bashkëpunimit ashtu që parashikuar që: *“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale”*.

Ndërsa në nenin 77 të KPRK-së, në paragrafin 1 është parashikuar dënimi për veprat penale në vazhdim, ku thuhet se: *“Vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim: 1.1. viktimës së njëjtë të veprës penale; 1.2. objekti i njëjtë i veprës; 1.3. shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore; 1.4. vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale; dhe 1.5. dashja e njëjtë e kryesit”*.

5. Vendimet e kryetarit të trupit gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, kryetari i trupit gjykues të akuzuarit K K, E RR, B Z, H H, E A dhe G T, i ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën janë ngarkuar ngase në veprimet e të akuzuarve të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale Kontrabandimi me migrantë ne bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 164 par. 2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata e rastin e shqiptimit të dënimeve ka vlerësuar se duhet të aprovohen rekomandimet e paraqitura në marrëveshjet për pranimin e fajësisë që ndaj të akuzuarve: K K, E RR, B Z, H H, E A dhe G T, të shqiptohen dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese dhe se dënimet me burgim dhe me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të jenë dënime të drejta dhe në harmoni me peshën e veprës penale.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarve me rastin e matjes së dënimit, gjykata i ka marrë për bazë disa rrethana rënduese dhe lehtësuese.

Si rrethana rënduese gjykata ka marr për bazë këto rrethana:

- Shkallën e Përgjegjësisë penale – që rezulton se të akuzuarit kishin vepruar me dashje direkte andaj shkalla e përgjegjësisë penale e të akuzuarve është konsideruar si shkalla më e lartë e fajësisë, përkatësisht e dashjes direkte, ngase të akuzuarit me falsifikimin e ndryshëm të dokumenteve shumica prej tyre zyrtare, kanë cenuar dhe rrezikuar sigurinë dhe besimin e qytetarëve ndaj autencitetit të dokumenteve, pra të dokumenteve që lëshohen nga organet shtetërore, ngase organet shtetërore garantojnë saktësinë e përmbajtjes dhe saktësinë të dokumenteve të cilët lëshohen nga ana tyre.

- Për të akuzuarin E RR, si rrethanë rënduese ka vlerësuar faktin se ka qenë i dënuar me parë sipas aktgjykimit të plotfuqishëm të kësaj gjykate PS.nr.28/19, me dënim me burgim dhe gjobë.

Si rrethana lehtësuese gjykata i ka marrë për bazë:

- Faktin se të akuzuarit kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, pra të akuzuarit kanë bashkëpunuar me prokuroren e shtetit dhe me organet e ndjekjes;

- Pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve me marrëveshjen për pranimin e fajësisë, pra para ngritjes së akuzës gjatë fazës hetimore të procedurës penale;

- Sjellja e të akuzuarve ka qenë korrekte me gjykatën gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjeve për pranimin e fajësisë;

- Faktin se të akuzuarit K K, B Z, H H, E A dhe G T, për herë të parë kanë rënë ndesh me ligjin, ku në bazë të të dhënave nuk rezulton se më herët kanë kryer ndonjë vepër penale-të ketë qenë të dënuar.

Andaj, duke pasur parasysh se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë sipas marrëveshjeve mbi pranimin e fajësisë si dhe duke mos gjetur rrethana tjera rënduese, Gjykata ka ardhur në përfundim se këto janë rrethana, që tregojnë se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe tek të akuzuarit me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryejnë ndonjë veprë tjetër penale dhe se dënimet e shqiptuara], sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimet do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëjë rehabilitimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Propozimet e mbrojtjes

Mbrojtësit e të akuzuarve gjatë seancës dëgjimore në lidhje me dënimin kanë propozuar që të akuzuarve t'iu mundësohet pagesa me këste e dënimeve me gjobë, mirëpo gjykata ka ardhur në përfundim se propozimet e tyre janë të pabazuara dhe të pambështetura në rrethana të arsyeshme në të cilat gjykata do të mund të lejonte që dënimi me gjobë të paguhej me këste, mirëpo në këtë drejtim duke marr për bazë shumat e dënimeve me gjobë të shqiptuara dhe duke u bazuar në nenin 43 të par.2 të KPRK-së, gjykata ka vendosur që të akuzuarve t'iu caktoj një afat më të gjatë për pagimin e dënimeve me gjobë, pra duke filluar nga një (1) muaj deri në tre (3) muaj për secilin të akuzuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e që afati prej tre (3) muajve është si afat më i gjatë që parasheh KPRK, për pagimin e dënimeve me gjobë, ashtu që gjykata ka vlerësuar afati i caktuar është optimal dhe i arsyeshëm që të akuzuarit do të mund ti paguajnë dënimet me gjobë të shqiptuara si në dispozitiv të aktgjykimit.

8. Vendimi mbi konfiskimin e sendeve

Gjykata ndaj të akuzuarit konform nenit 270 KPP-së, ka konfiskuar sendet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi si mjete – pasuri që janë përdorë me kryerjen e veprës penale (objekte të veprës penale) dhe më pas ka obliguar Agjencinë për Sekuestrimin e Pasurisë së Konfiskuar në Prishtinë që t'i marr nën administrim dhe menaxhim sendet e konfiskuara të administrojë me të njëjtat dhe sendet e lartcekura t'i shesë dhe paratë nga shitja t'i administroi në përputhje me Ligjin mbi Agjencinë.

9. Vendimi lidhur me kthimin e mjeteve të sekuestruara

Duke u bazuar në nenin 113 të KPP-së, gjykata ka vendosur që të bëjë kthimin e mjeteve dhe pasurive të cekura si në pikën III të dispozitiv të këtij aktgjykimi, për shkak se PSRK kishte kërkuar kthimin e tyre, pra nuk kishte bazë për konfiskimin e tyre, e që edhe sipas dispozitës së lartpërmendur përcaktohet se: *“Përveç siç parashihet në nenin 276 të këtij Kodi, provat apo pasuria e specifikuar të sekuestruara përkohësisht apo ndaluara gjatë procedurës penale i kthehen pronarit ose poseduesit kur procedura pushohet ose kur nuk ka bazë për sekuestrimin e përkohshëm apo konfiskimin e tyre”*. Gjithashtu Gjykata, ka obliguar Agjencinë për Sekuestrimin e Pasurisë së Konfiskuar në Prishtinë që të akuzuarve t’iu kthej – dorëzojë mjetet dhe pasuritë e cekura si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit.

10. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe par.2 nënpar.2.6, nenit 450 par.1 dhe nenit 452 të KPP-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.3 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 364 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

- DEPARTAMENTI SPECIAL -

PS.nr.2/24, me datë 31.01.2024

**Zyrtarja ligjore,
Mirjetë Demiri**

**Kryetari i trupit gjykues,
Mentor Bajraktari**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë - Departamenti Special, nëpërmjet kësaj Gjykate.